



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

Hapet thirrja për mobilitet (bursë) stafi të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +
në Polytechnic Institute of Viseu (IPV), Portugali.

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikim për bursë për mobilitet për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Polytechnic Institute of Viseu (IPV).

Lloji i mobilitetit përfshin: Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie.

Fusha e studimit:

- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike.

Kohëzgjatja e bursës: 5 ditë + udhëtimi, semestri i II i vitit akademik 2021 – 2022.

Numri total i stafit: 8

Dokumentat e nevojshme për aplikim për mësimdhënie për stafin:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Diploma e nivelit të fundit të studimeve;
- Çertifikata e gjuhës së huaj (Niveli minimal i gjuhës angleze B2);
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës**;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching) për stafin akademik në universitetin pritës***.

**Plani i mobilitetit për mësimdhënie (teaching), si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë.*

***Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aprovues, të cilin do të duhet ta bashkangjisi me dokumentet e tjera për aplikimin tuaj.*

**** Mobility Agreement për Teaching (mësimdhënie) për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi i juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 7 Maj 2022

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: abeqo@upt.al ose rkodra@upt.al.